



Planuar / Dorezuar Priljet/Prodato Received/ Delivered	23.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtoji e Prilog Zpendis	Sasia Kolicina Quantity
SKAMRACK	5790/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.961/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Koleji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.961/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.961/2023 e datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 859 të datës 18.07.2016 në pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor" në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 12.07.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 14.07.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.961/2023, me pretendimet ankimore se nuk jam kompensuar në pagë sipas akt emërimit duke kërkuar që nga data 18.07.2016 deri në parashtrim të ankesës të kompensohet sipas ligjit në fuqi për zyrtarët publikë dhe ligjit të pagave për zyrtarët publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.07.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Fushë Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 21.07.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur më çështjen në procedurë të shqyrtimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5212/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit me Nr. 859 të datës 18.07.2016; Dokument identifikimi i ankueses; Kartelën e nëpunësit nga viti 2016 deri në vitin 2023; Zarin e datës 12.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 21.07.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është kompensuar në pagë sipas akt emërimit duke kërkuar që nga data 18.07.2016 deri në parashtrim të ankesës të kompensohet sipas ligjit në fuqi për zyrtarët publikë dhe ligjit të pagave për zyrtarët publikë.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficienteve, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesja nga data 18.07.2016 është punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor" në Komunën e Fushë Kosovës, me gradën tetë (8), ku ka realizuar koeficient shtatë (7) të pagës dhe se e njëjta përkundër faktit se ka qenë në djeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 14.07.2023 (data e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës), rrjedhimisht ankuesja nuk e kishte kundërshtuar Akt Emërimit me Nr. 859 të datës 18.07.2016 në kuptim të koeficientit të pagës respektivisht të ardhurave personale në pagë.

Kolegji i Këshillit, marr për bazë provat e lëndës, e përmes të cilave konstatohet se ankuesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim juridik në raport me pretendimet e saja që nga koha e themelimit të marrëdhënies së punës, rrjedhimisht në kohën kur pala ankuese ka themeluar marrëdhënie pune ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar në Këshill lidhur me pretendimin për kompensim e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 18.07.2016 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative me të cilin përcaktohej se " Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi", kështu që meqenëse ankuesja nga data e nënshkrimit të Akt Emërimit me Nr. 859 të datës 18.07.2016 e deri me datë 14.07.2023 nuk ka ndërmarr ndonjë veprim juridik në kuptim të kompensimit në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës rrjedh se ankesa e



ankueses A.nr.961/2023 e datës 14.07.2023 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar edhe me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.961/2023, datë 23/08/2023.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

